

THIRRJE PUBLIKE

Për paraqitjen e drejtorëve të shkollave për të ndjekur trajnim të avancuar

Të nderuar,

Ju njoftojmë se Qendra Shtetërore e Provimeve po fillon me organizimin dhe realizimin e trajnimit të avancuar për drejtor në shkollë.

Në bazë të Ligjit për trajnimin dhe provimin për drejtor në shkollë fillore, shkollë të mesme, konvikt nxënësish dhe universitet të hapur civil për mësim të përjetshëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 10/2015, 145/2015, 192/2015, 30/2016, 120/2018 dhe 140/2018) çdo **drejtor shkolle** që ka **të dhënë provimin për drejtor** është i detyruar të ndjekë trajnimin e avancuar prej së paku 4 ditë seminarike (nga 8 orë), me kohëzgjatje totale prej 32 orë gjatë vitit.

Aplikim dorëzon drejtori aktual (u.d. drejtor) i shkollës me certifikatë të vlefshme për drejtor. Me fletë-aplikimin detyrimisht dorëzohet:

- Vendimi për përzgjedhjen/emërimin për drejtor (kopje) dhe
- Kopja e fletëpagesës për shumën e derdhur prej 2500 denarë për trajnimin e parë.

Aplikimi me dokumentacionin e kompletuar dorëzohet **VETËM ME ANË TË POSTËS** pranë Qendrës Shtetërore të Provimeve në adresën: rr. "Vasil Gjorgov" p.n., 1000 Shkup, dërguar **më së voni deri më 27.10.2023 (e premte)**.

Numri i përgjithshëm i trajnimeve 4 (katër) për çdo drejtor duhet të realizohet gjatë vitit akademik 2023/24, prandaj është e nevojshme të përzgjidhni katër nga temat e mëposhtme.

Në fletë-aplikim është e nevojshme të regjistroni shifrat e temave të përzgjedhura (kur zgjidhni, kushtojini vëmendje gjuhës në të cilën zhvillohet trajnimi)

TRAJNIMET	Shifra e trajnimit
Menaxhimi financiar (në gjuhën maqedonase)	FR01
Menaxhimi financiar (në gjuhën shqipe)	FR02
Punë administrative dhe arkivore (në gjuhën maqedonase)	AA01
Inkluziviteti – sfidë në shkolla, praktikat pozitive (në gjuhën maqedonase)	INK01
Mobingu, aspektet psikosociale dhe mbrojtja ligjore (në gjuhën maqedonase)	MOB01
Mobingu, aspektet psikosociale dhe mbrojtja ligjore (në gjuhën maqedonase me përkthyes në gjuhën shqipe)	MOB02
Inkuadrimi i kuadrit mësimor dhe profesional (praktikantëve) në procesin edukativ-arsimor në shkollat fillore dhe të mesme në RMV (në gjuhën maqedonase)	PRI01

Inkuadrimi i kuadrit mësimor dhe profesional (praktikantëve) në procesin edukativ-arsimor në shkollat fillore dhe të mesme në RMV (në gjuhën maqedonase me përkthyes në gjuhën shqipe)	PRI02
Lufta kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesave në sistemin arsimor (në gjuhën maqedonase)	KOR01
Lufta kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesave në sistemin arsimor (në gjuhën shqipe)	KOR02
Kompetencë digjitale me aplikimin e teknologjisë së informacionit dhe kompjuterike në mësimdhënie dhe shkollë (në gjuhën maqedonase)	DIG01
Kompetencë digjitale me aplikimin e teknologjisë së informacionit dhe kompjuterike në mësimdhënie dhe shkollë (në gjuhën shqipe)	DIG02
Përvetësimi i shkathtësive për të kontrolluar cilësinë e vlerësimit të njohurive të nxënësve në shkolla (në gjuhën maqedonase)	OCN01
Përvetësimi i shkathtësive për kontrollin e cilësisë së vlerësimit të njohurive të nxënësve në shkolla (në gjuhën shqipe)	OCN02

Orarin e realizimit të trajnimeve individuale, përkatësisht terminin tuaj do ta merrni në email, ndaj është e rëndësishme që qartë dhe lexueshëm të plotësoni të dhënat në fletë-aplikim. Trajnimet e para do të fillojnë në nëntor të vitit 2023. Trajnimi për një temë të caktuar do të mbahet pas regjistrimit të minimum 20 personave të regjistruar.

Drejtorët për ndjekjen e trajnimit të avancuar paguajnë mjete në vlerë prej 2.500,00 denarë për trajnim. Për çdo trajnim të mëpasshëm do të dorëzohet një fletëpagesë në ditën e trajnimit sipas orarit.

Fletëpagesën duhet plotësuar në këtë mënyrë:

Qëllimi i dërgesës: Pagesë për ndjekjen e trajnimit të avancuar (detyrimisht shënoni se cili trajnim është i radhës për ju: i pari, i dyti, i treti ose i katërti);

Emri i pranuesit: Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut;

Banka pranuese: Banka popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut;

Llogaria transaksionale:100000000063095;

Llogaria e shfrytëzuesit buxhetor: 1600261506 787 16;

Shifra e të hyrave: 723013;

Programi: 30.

Personat të cilët më vonë do të plotësojnë kushtet për ndjekjen e trajnimit të avancuar mund të aplikojnë në mënyrë plotësuese.

Tel. për kontakt: 075340963

Me respekt,

Qendra Shtetërore e Provimeve